



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**

**Nr. 14, datë 21.01.2021**

**PËR**

**PËRBËRJEN E KOMISIONIT TË PËRKOHSHËM PËR SHQYRTIMIN E ANKIMEVE  
KUNDËR VENDIMEVE TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR  
ARKIVIMIN E ANKIMIT OSE PUSHIMIN E HETIMIT NDAJ NJË GJYQTARI, PËR  
VITIN 2021**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenin 62, pika 13 të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në vendimin nr. 170, datë 28.05.2020 “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve Kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari”, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, pas procedurës shortit,

**VENDOSI:**

1. Përbërja e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve Kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari (KPSHA), për vitin kalendarik 2021, është si më poshtë:

1. Znj. Brikena Ukperaj – anëtare;
2. Z. Maksim Qoku – anëtar;
3. Z. Erjon Muharremaj – anëtar.

Anëtarë zëvendësues të këtij komisioni të përkohshëm janë:

1. Z. Alban Toro – anëtar;
2. Z. Dritan Hallunaj – anëtar.

2. Komisioni ushtron veprimtarinë e tij bazuar në Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari”, miratuar me vendimin nr. 200, datë 11.06.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Ankimimet objekt i veprimtarisë së KPSHA, të ardhura deri tani dhe për të cilat nuk ka ende një vendimmarrje, dorëzohen pranë Komisionit të Përkohshëm të krijuar në pikën 1 të këtij vendimi, nga anëtari i cili nuk vijon të jetë anëtar i këtij Komisioni. Në çdo rast dokumentohet procesi i dorëzimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**